

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

# Martestat e hershme në Shqipëri

## Rreth këtij fenomeni në vend

Martesa e fëmijëve - martesa zyrtare ose bashkimi jo-zyrtar i çdo personi nën moshën 18 vjeç - është një shkelje e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijës. Martesa e fëmijëve i vendos bashkëshortët fëmijë dhe në veçanti, vajzat e martuara, në rrezik ndaj dhunës në familje, abuzimit seksual, përdhunimit dhe mohimit të qasjes në arsim.

Të dhënat zyrtare të vitit 2017 tregojnë se 16.9% ishin martesa nën moshë, shifër në të cilën përfshihen vetëm-martestat e regjistruara, dhe për martestat e pa regjistruara nuk dihet shkalla e vërtetë e përhapjes. Vihet re që norma e martesës së fëmijëve janë shumë të larta në komunitetet Rome, por nuk ka të dhëna të sakta statistikore.

## Zhgënjimi i lumturisë së martesës së hershme

Gratë e intervistuar dhe të marra në konsideratë në këto raste studimore evidentojnë se martesa e hershme pengon përparimin shkollor dhe profesional. Shumica e tyre kanë një nivel të ulët arsimor dhe nuk planifikojnë të kthehen në shkollë pas lindjes së fëmijës. Për më tepër, ato nuk e shohin veten e tyre duke zhvilluar një jetë profesionale jashtë familjes. Mungesa e arsimit dhe e mundësive ka një ndikim mjaft negativ tek gratë që duan të riintegrohen dhe pasojat e kësaj situatë kanë ndikim të gjerë për të gjithë shoqërinë.

**ZGJËNDRRA E LUMTURISË SË MARTESËS SË HERSHME: RASTE STUDIMORE PËR MARTESËN NË MOSHË TË MITUR NË KORÇË DHE VLORE**



## Thirrje për VEPRIM

- Shteti Shqiptar duhet ta konsiderojë prioritet ndalimin e martesën e fëmijëve nëpërmjet masave politike në nivel qendror dhe lokal, duke përcaktuar ndërhyrjet, buxhetet e lidhura, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e entiteteve të ndryshme publike. *(Rekomandim që nga viti 2018)*
- Nevoja për të evidentuar në mënyrë specifike se martesat e hershme janë të dënueshme në Legjisllacionin Shqiptar. *(Rekomandim që nga viti 2015)*
- Nevoja për të adresuar fenomenin e martesave të hershme në Planin e veprimit Kombëtar të Integritetit të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri 2015-2020. ; *(Rekomandim që nga viti 2015)*
- Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve Shqiptarë ka nevojë të reflektojë fenomenin e martesave të hershme. *(Rekomandim që nga viti 2015)*
- Fenomeni i martesave të hershme duhet të ketë vëmendje të veçantë nga aktorë të ndryshëm institucional dhe jo institucional në mënyrë që të zvogëlohet ky fenomen dhe efektet e tij; *(Rekomandim që nga viti 2015)*



## Kuadri Ligjor në lidhje me martesat nën moshë

E drejta për t'u martuar dhe e drejta për të pasur familje është pjesë e të drejtave themelore të njeriut. Realizimi i kësaj të drejte ka kufizimet e veta ligjore. Një prej tyre është arritja e moshës madhore [shih neni 7 i KF].

Të tjera janë mungesa e pëlqimit të lirë [neni 8 KF], martesat ekzistuese nëse kërkohet të lidhet një martesë e re, sëmundje e rëndë psikike ose zhvillimi mendor i metë, i tillë që e bën të paaftë të kuptojë qëllimin e martesës, etj [shih neni 7-14 të KF].

Të gjitha rastet, përfshirë martesën nën moshë

ose martesën pa pëlqimin e lirë, bëjnë që martesat të lidhur të jenë të pavlefshme.

KF [2003] parashikon të njëjtat kushte dhe pengesa martesore për të dy bashkëshortët e ardhshëm. Po kështu, nuk ka asnjë dispozitë diskriminuese lidhur me moshën e martesës.

Efektet negative të martesës së hershme kanë tendencë të manifestohen në shtet dhe mëvonshme të zhvillimit jetësor, duke përfshirë çështjet që lidhen me shëndetin dhe mirëqenien psikologjike.

*Shteti Shqiptar duhet ta konsiderojë prioritet ndalimin e martesës nën moshë dhe rolin e gjykatës nëpërmjet masave politike në nivel qendror dhe lokal.*

### Thirrje për VËMENDJE

- \* Parandalim dhe mbështetje për fëmijët e prekur nga martesat nën moshë. (Rekomandim që nga viti 2018)
- \* Sensibilizim dhe Edukim, - Ndryshimin e qëndrimeve dhe normave rreth martesës së fëmijëve kërkon përpjekje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në nivel komuniteti, duke angazhuar një sërë aktorësh, përfshirë mësuesit, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit socialë, krerët e komuniteteve, e të tjerë (Rekomandim që nga viti 2018)
- \* Për gjykatën, mbajtja në vëmendje e interesit të të miturit, duhet të jetë konsiderata kryesore dhe ky kujdes i veçantë nevojitet të pasqyrohet në mënyrë sa më të qartë përmes analizës konkrete sipas rastit, në përmbajtjen e vendimit. (Rekomandim që nga viti 2018)

## Në rastet e lejimit të martesës nën moshë, gjykatës, 'i bie barra' të kuptojë:

- ⇒ Sa reale janë shkaqet me rëndësi të pretenduara për lidhjen e martesës nën moshë kundrejt rrezikut të cënimit të standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe shkeljes së parimit të moshës për martesë;
- ⇒ Sa mundësi ka që përmes gjykatës të ligjërohet ende zakoni dhe traditat e martesave pa pëlqim të lirë, ose të martesave me 'mblesëri a shkuesi', ose të martesave me detyrim;
- ⇒ A ekziston pëlqimi i lirë i të miturit;
- ⇒ A e kupton i mituri se çfarë është martesë, çfarë efektesh ka në të drejtat e tij/saj, etj.

Në Shqipëri janë ende evidente raste të martesave me mblesëri ose ndërmjetësim dhe ndaj gjykatës, në raste të tilla, duhet të ketë parasysh se çfarë rreziqesh shfaq kjo lloj martesë në parimin e 'pëlqimit të lirë'.

Ajo që vihet re nga monitorimi i praktikës gjyqësore dhe analiza e vendimeve mbi lejimin e lidhjes së martesës nën moshë, është se nuk ka asnjë rast rrezikimi të kërkesës për lidhjen e martesës nën moshë.

